



### VENDIM

Nr. 63 datë 11.05.2015

### PËR

## FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “ENERGAL” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 5 pika 1 gërma “g”; 8 dhe 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.05.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ENERGAL” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

### Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “ENERGAL” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

Për dokumentacionin e përgjithshëm:

Neni 9, pika 1- Formati i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 3 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar tërësisht.

Neni 9, pika 4/10, gërma “a” Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar i plotësuar.

Neni 9, pika 4/10, gërma “b” kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e aktivitetit i plotësuar.

Neni 9, pika 4/10, gërma “c” Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “ENERGAL” sh.p.k, nuk ka realizuar kontrata te mëparshme me objekt tregtimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për liçensimin e shoqërisë “ENERGAL” sh.p.k, ne aktivitetin e Tregimit te Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

**Petrit AHMETI**